



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

PLANI I PUNËS I PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA PËR VITIN 2015

Janar, 2015

Adresa: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Ndërtesa e ish Bakës së Lubjanës kati I-, Prishtinë 10000
Telefoni: +381 (0) 38 211 242. Emali: www.pzap-ks.org

Hyrje

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), është themeluar në bazë të nenit 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr 03 / L-072).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me ligj dhe rregullat zgjedhore.

Në pajtim me LZP, PZAP, me përgjegjësi zbaton Rregullat Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së) dhe Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it të nxjerra me 8 Tetor 2009 e cila Rregullore ne përputhje me nenin 117.1 të LZP-së është amandamantuar dy here me 23 Qershor 2010, dhe me 17 nëntor 2010.

Ne ushtrimin e përgjegjësi dhe funksioneve të tij, respektivisht në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me LZP, PZAP-i mbështetet nga personeli i administratës së Sekretariatit i cili punon në pajtim me këtë ligj.

Sekretariatit i PZAP-it, ka dhjetë zyrtar të administratës përfshirë kryesuesin e tij i cili, nën drejtimin e kryesuesit të PZAP-it, është përgjegjës për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it, përgatitjen e paneleve të PZAP-it, organizimin e Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionet e PZAP-it.

Sekretariatit i PZAP-it, ka buxhetin vjetor të ndarë nga Buxheti i Republikës së Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e duhur të Sekretariatit.

PZAP-i, me qëllim të zbatimit të përgjegjësi dhe lehtësimit të përmbushjes së detyrave të veta harton dhe miraton Planin e Punës për Vitin 2015 në të cilin plan janë të paraqitura objektivat dhe aktivitetet e institucionit për realizimin e synimeve të përcaktuara. Plani i punës përcakton edhe afatet kohore dhe përgjegjësit për kryerjen/përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteteve të parapara si dhe koston financiare.

PËRBËRJA E PANELIT TË PZAP-it

PZAP-i, përbëhet nga 10 (dhjetë) anëtarëve përfshirë këtu edhe kryesuesin dhe mund të mblidhet në panele prej së paku 3 (tre) anëtarëve, prej të cilëve një është kryesues.

Anëtarët e emëruar të PZAP-it sipas LZP-së, gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtarë të PZAP-it.

Për çdo panel caktohet një kryesues i panelit për seancën e caktuar. Kryesuesi i Panelit të PZAP-it cakton përbërjen e paneleve.

PËRGJEGJËSITË DHE FUNKSIONET

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) është një organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me ligj dhe rregullat zgjedhore.

KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-it

PZAP-i, me qëllim të ushtrimit të funksionit dhe përgjegjësisë së tij ka formuar dy (2) komisione të përhershëm siç janë: Komisioni për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pesë) anëtarëve të panelit dhe Komisioni për Buxhet dhe Personel i përberë prej 5 (pesë) anëtarëve të panelit. Roli i këtyre komisioneve është shqyrtimi i çështjeve të caktuara profesionale për çka janë formuar siç janë përgatitja e rekomandimeve për miratim nga PZAP-i, respektivisht shqyrtimi i çështjeve që lidhen me mandatin dhe organizimin e PZAP-it e të cilat ndikojnë në përmirësimin, ngritjen dhe zhvillimin e performances së tij.

QËLLIMI I PLANIT VJETOR TE PUNËS

PZAP-i, për çdo vit përgatit Planin Vjetor të Punës për të arritur me lehtë qëllimet e synuara dhe me rastin e përgatitjes së këtij plani për arritjen e rezultateve të synuara bazohet në mandatin e përcaktuar me ligj, duke u udhëhequr nga prioritetet e institucionit sipas nevojës dhe arsyes, disponueshmërisë së kapaciteteve njerëzore, fondeve buxhetore si dhe në baze të performances së rezultateve në punë nga viti paraprak.

Plani Vjetor i Punës për vitin 2015 pasqyron një planifikim deri diku të detajuar, por jo të kufizuar të aktiviteteve dhe përcakton pritshmërinë e realizimit të punëve dhe detyrave të identifikuar gjatë vitit.

Plani Vjetor i Punës përmban: objektivat, rezultatet e pritura, aktivitetet që do të kryhen për arritjen e rezultateve të pritshme; korniza kohore për ndërmarrjen e aktiviteteve të planifikuara; bartësit/përgjegjësit për kryerjen e aktiviteteve, mbikëqyrësit e implementimit të aktiviteteve, dhe kostoja.

SHKURTESAT

PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokuroria i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
PK	Policia e Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore
MF	Ministria e Financave
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SP	Subjekte Politike
KP	Kandidat i Pavarur
KÇL	Komisioni për Çështje Ligjore
KBP	Komisioni për Buxhet dhe Personel
ZRPPC	Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
LZP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LZL	Ligji për Zgjedhjet Lokale
RRZ	Rregullat Zgjedhore të KQZ-së
RRP	Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it
RRKSGJ	Rregulla për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave

Objektivat/detyrat e punës		Aktivitetet/Veprimet		Afati kohor	Përgjegjës	Kosto
1	Plotësimi i Komisioneve te Përhershme te PZAP-it me anëtarë te ri, respektivisht Plotësimi i Komisionit për Çështje Ligjore dhe Komisionit për Buxhet dhe Personel	1.1	Nxjerrja e Vendimit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr. 4-06/2011 te datës 15.06.2011, Te Komisionit te Përhershëm për Çështje Ligjore dhe nxjerrja e Vendimit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr. 5 -06/2011 te datës 15.06.2011 Te Komisionit te Përhershëm për Buxhet dhe Personel	Maj 2015	Anëtarët e PZAP-it/ Personeli i SPZAP-it	
2	Shqyrtimi dhe vendosja e ankesave/apelve te lejuara për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Graçanices	2.1	Hartimi i Planit te Veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar te Komunës se Graçanices,	Janar 2015	PZAP-it/SPZAP-it	
		2.2	Bashkëpunimi i PZAP-it me Komisionin Qendror Zgjedhor – KQZ, (PZAP-i sipas kërkesës se KQZ-së te njëjtën e njofton me emrat e personave qe me vendime ju ka ndaluar te drejtën qe te jene kandidatë për zgjedhje dhe pjese e stafit administrativ te zgjedhjeve qe organizohen nga KQZ-ja dhe e njofton me gjobat e papaguara nga ana e subjekteve politike para certifikimit te subjekteve politike dhe kandidatëve për kryetar te komunës dhe konfirmon përfundimin e procesit te ankesave për certifikimin e rezultateve te Zgjedhjeve ne Graçanice.	Janar 2015	PZAP-it/SPZAP-it	
		2.3	Bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit, Policinë e Kosovës dhe Gjykatën Supreme për Zgjedhjet ne Graçanice.	Janar 2015	PZAP-it/SPZAP-it	
		2.4	Miratimi i vendimit për caktimin e tri (3) Paneleve	Janar 2015	Kryesuesja me anëtarët e PZAP-it	
		2.5	Miratimi i Vendimit për punë jashtë orarit te punës dhe përgatitja e Planit te punës për punë jashtë orarit te punës	Janar 2015	Kryesuesi i SPZAP	
		2.6	Miratimi i vendimit për kompensimin/pagesën e orëve jashtë orarit te punës per stafin administratës se sekretariatit te PZAPi-t	Janar 2015	Kryesuesi i SPZAP	2,000.00 €
3	Zhvillimi i Kapaciteteve Njerëzore	3.1	Punëtorja ne Durrës –Shqipëri, për anëtarët e PZAP-it dhe një pjese te personelit te administratës se SPZAP-it	Mars – Prill 2015	Kryesuesi i PZAP-it/ Kryesuesi i SPZAP-it	10,000.00 €
		3.2	Vëzhgimi i Zgjedhjeve ne shtetet e rajonit	Janar – Dhjetor 2015	Kryesuesi i PZAP-it/ Kryesuesi i SPZAP-it	20,000.00 €
		3.3	Trajnime për stafin e administratës se sekretariatit te PZAP-it	Janar – Dhjetor 2015	Kryesuesi i PZAP-it/ Kryesuesi i SPZAP-it	15,000.00 €
		4.1	Përgatitja e amendamenteve lidhur me mandatin te PZAP-it për Ligjin e Përgjithshëm te Zgjedhjeve, nëse do te ketë ndryshim te këtij ligji.	Janar – Dhjetor 2015	PZAP/SPZAP	3,000.00 €

4	Rishikimi dhe zbatimi Kornizës Ligjore	4.2	Rishikimi i Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, dhe Rregullores për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobjave,	Shtator – Dhjetor 2015	PZAP/SPZAP	2,000.00 €
		4.3	Miratimi i një rregullore te brendshme për hetimin e rasteve ne QNR dhe ne teren.	Shtator – Dhjetor 2015	PZAP/SPZAP	2,000.00 €
		4.5	Formimi i dy (2) komisioneve te përhershme te PZAP-it: për Çështje Ligjore dhe për Çështje administrative - buxhet dhe personel	Janar – Maj 2015	PZAP/SPZAP	
		4.6	Rishikimi i vendimeve për shpenzime te reprezentacionit, për përdorimin e automjeteve dhe përdorimit te telefonave fiks dhe mobil	Janar – Qershor 2015	Kryesuesi i PZAP-it/ Kryesuesi i SPZAP-it	
5	Çështjet e Prokurimit	5.1	Lidhje e kontratës për Veb faqen e PZAP-it dhe mirëmbajtja e saj.	Shtator 2015	SPZAP	1,500.00 €
		5.2	Lidhje e kontratës për Servisimin e pajisjeve te teknologjisë informative te PZAP-it dhe mirëmbajtja e tyre.	Janar 2015	SPZAP	2,000.00 €
		5.3	Lidhje e kontratës për mirëmbajtjen e hapësirave dhe te zyrave te PZAP-it	Mars 2015	SPZAP	3,500.00 €
		5.4	Lidhje e kontratës pre servisimin e automjeteve	Mars - Prill 2015	SPZAP	3,500.00 €
		5.5	Lidhje e kontratës për sigurimin automjeteve	Mars - Prill 2015	SPZAP	2,500.00 €
		5.6	Lidhje e kontratës për furnizim me material zyrtar	Mars - Prill 2015	SPZAP	8,500.00 €
6	Vendosja e një procesi efektiv te komunikimi për përmirësimin e performacës se PZAP-it dhe perceptimit te publikut.	6.1	Bashkëpunimi PZAP-it me Komisionin Qendror Zgjedhor – KQZ, Te organizohen se paku dy takime te te përbashkëta ne mes te sekretariateve te PZAP-it dhe KQZ-se për përmirësimin komunikimit dhe njëkohësisht performaces se dy institucioneve.	I pari ne gjashtë mujorin e pare te vitit 2015 organizuar nga PZAP-i. I dyti ne gjashtë mujorin e dyte te vitit 2015 organizuar nga KQZ-ja	SPZAP/SKQZ	500.00 €
		6.2	Bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit, për rastet e ankesave me element te veprës penale te dorëzuara ne Prokurori.	Janar – Dhjetor 2015	SPZAP-it/PSH	
		6.3	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, për ndonjë rast te hetimeve nga zgjedhjet e kaluara.	Janar – Dhjetor 2015	SPZAP/PK	
		6.4	Bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor me Gjykatat e rregullta për rastet e ankesave lidhur me zgjedhjet e kaluara.	Janar – Dhjetor 2015	SPZAP/KGJK	
		6.5	Bashkëpunimi i PZAP-it me Organizatën peri Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE. OSBE përveç përkrahjes këshilluese profesionale dhe institucionale qe do ti ofron PZAP-it ne bashkëpunim me IFES, PZAP-in do ta përkrah teknikisht dhe profesionalisht edhe ne Projektin e Sistemit te Menaxhimit te Rasteve te Ankesave /Apeleve te Zgjedhjeve dhe shkresave tjera te lendes	Janar – Dhjetor 2015	SPZAP/OSBE/IFES	

		6.6	Bashkëpunimi i PZAP-it me IFES. IFES përveç përkrahjes në aspektin transparencës publike që do të ofroj PZAP-it, në bashkëpunim me OSBE, PZAP-in do ta përkrah profesionalisht dhe financiarisht në një projekt shumë të rëndësishëm për institucionin tonë në Projektin e Sistemit të Menaxhimit të Rasteve të Ankesave /Apeleve të Zgjedhjeve dhe shkresave tjera të lëndës	Janar – Dhjetor 2015	SPZAP/IFES/OSBE	
		6.7	Bashkëpunimi i PZAP-it me OJQ: KDI, D4D Lidhur me informatat dhe statistikat zgjedhore dhe shpalojen e tyre publikut.	Janar – Dhjetor 2015	SPZAP/OJQ	
		6.8	Bashkëpunim i PZAP-it me mediet e shkruara dhe elektronike, për informimin e publikut me aktivitetet e zhvilluara nga PZAP-i,	Janar – Dhjetor 2015	SPZAP/MEDIE	
		6.9	Publikimi/Postimi në Veb Faqen e PZAP-it të të gjitha Vendimeve dhe akteve të rëndësishme, Planet e punës, Raportet e punës, Komunikatave për medie, dhe rifreskimi i Web Faqes gjatë vitit.	Janar – Dhjetor 2015	SPZAP	
7	Financat dhe buxheti: Sigurimi i mbështetjes adekuate financiare për përmirësimin e performances së PZAP-it dhe zbatimit të lehtë të aktiviteteve të planifikuara	7.1	Barazimi vjetor i shpenzimeve me SMFK me librin financiar të SPZAP-së për vitin fiskal 2014 Përgatitja e Pasqyrave Financiare për vitin fiskal-2014,	Prej 15 janarit deri 30 janar-2015	SPZAP-it/ZKF/ZKA	
		7.2	Përgatitja e dokumentacionit për Cesh Plan të Buxhetit për vitin 2015 dhe futja e të dhënave në Softverin e Cash Planit duke planifikuar shpenzimet dhe zotimet në baza mujore për secilën kategori ekonomike, Përgatitja e dokumentacionit për tërheqjen – hapjen e Petty Cashit si dhe menaxhimin e parave të imta,	Janar 2015	SPZAP-it/ZKF/ZKA	
		7.3	Mbikëqyrja e punës së komisioneve për inventarizim, vlerësim dhe tjetërsim të formuara nga Kryesuesi i SPZAP-it, Përgatitja e raportit të përgjithshëm përfundimtar të këtyre komisioneve,	Fillimi i janarit - 2015	SPZAP-it/ZKF/ZKA	
		7.4	Procedimi dhe kontrollimi i të gjitha faturave që janë për pagesë; Përgatitja e dokumentacionit për pagesë të secilit shpenzim të ndodhur Koordinim të aktiviteteve me zyrtarin zotues për zotimin e mjeteve financiare, me zyrtarin pranues, me zyrtarin certifikues për certifikimin e dokumenteve financiare si dhe me zyrtarin e prokurimit për aprovim të dokumenteve financiare me procedurë të prokurimit,	Mund të jete ditore varësisht kur ndodhin shpenzimet	SPZAP-it/ZKF/ZKA	

			Shpenzimi i mjeteve në SMFK, Regjistrimi i të gjitha shpenzimeve në Librin Financiar,			
8	Planifikimi i Buxhetit	8.1	Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2016-2018) për vitin 2016 si dhe vlerësimet për dy vite tjera 2017 dhe 2018, ku në KASH përfshihen Misioni i PZAP-it, Situata Aktualë si dhe Objektivat e PZAP-it në një periudhë afatmesme,	Prill - 2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		8.2	Përgatitja e kërkesave të para Buxhetore,	Prill-Maj-2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		8.3	Futja e kërkesave të para Buxhetore në Sistemin e BDMS-së dhe në Sistemin e PIP-it nëse kemi projekte kapitale,	Maj – Qershor - 2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		8.4	Shqyrtimi i Qarkores se dytë Buxhetore për vitin 2016,	Qershor-Korrik-2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		8.5	Përgatitja e kërkesave të dyta Buxhetore,	Qershor-Korrik-2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		8.6	Futja e kërkesave të dyta Buxhetore në Sistemin e BDMS-së dhe në Sistemin e PIP-it nëse kemi projekte kapitale,	Qershor-Korrik-2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		8.7	Dëgjimet Buxhetore	Gusht – Shtator -2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		8.8	Finalizimi i buxhetit për vitin e ardhshëm dhe aprovimi i tij nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit.	Shtator-Nëntor-2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
9	Monitorimi dhe Raportimi i Buxhetit	9.1	Monitorimi dhe përcjellja e Librit Financiar ku mbahet evidenca e të gjitha transaksioneve të shpenzimeve,	Përcjellje e vazhdueshme		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		9.2	Përgatitja e raporteve mujore të shpenzimeve,	Mujore		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		9.3	Përgatitja e raporteve tremujore të shpenzimeve ku bëhet barazimi tremujor i shpenzimeve me Departamentin e Thesarit,	Tre mujor		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		9.4	Përgatitja e Pasqyrave Financiare nëntëmujore për vitin Fiskal 2015,	Tetor 2015		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		9.5	Përgatitja e Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin Fiskal 2015,	Dhjetor 2015 – Janar 2016		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		9.6	Përgatitja e Raportit Vjetor Financiar për Vitin Fiskal-2015.	Dhjetor 2015 – Janar 2016		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		9.7	Plotësimi i formularit për Vetëvlerësim të kërkuar nga MF- NJH.	Dhjetor 2015 – Janar 2016		SPZAP-it/ZKF/ZKA
10	Menaxhimi i te Hyrave	10.1	Regjistrimi dhe monitorimi i të gjitha të hyrave të shqiptuara,	Përcjellje e vazhdueshme		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		10.2	Regjistrimi dhe monitorimi i të gjitha të hyrave të realizuara,	Përcjellje e vazhdueshme		SPZAP-it/ZKF/ZKA
		10.3	Përgatitja e raporteve për te hyra	Përcjellje e vazhdueshme		SPZAP-it/ZKF/ZKA

11	Çështjet e Teknologjisë Informative	11.1	<p>Administrimin e sistemit dhe proceseve të ndërlidhura direkt me TI;</p> <p>Mirëmbajtjen e infrastrukturës së TI të PZAP-it, duke përfshirë lidhjen në rrjet, kyçjen në domain qasjen në Internet, hapjen dhe qasjen në email adresa etj;</p> <p>Bashkëpunim me zyrtaret e sektorit të telefonisë fikse të MAP-it dhe mirëmbajtje të sistemit të telefonisë fikse të PZA-it;</p> <p>Mirëmbajtjen e kompjuterëve personal dhe softuerit të zyrtareve të PZAP-it;</p> <p>Sigurimin e sistemit të PZAP nga ndërhyrjet e jashtme dhe të brendshme;</p> <p>Menaxhim të performancës dhe pajisjeve të TI dhe sigurinë e tyre;</p> <p>Rekomandim për buxhetin vjetor të investimeve për mirëmbajtje, zhvillim dhe ripërtëritje të sistemeve;</p> <p>Ndihmë për përdoruesit në shfrytëzimin e resurseve të rrjetit;</p> <p>Instalimin e pajisjeve kompjuterike periferike si shtypësit dhe skanerët;</p> <p>Ruajtjen e të dhënave nga serverët në kopje në njësi dhe medium të aprovuara për backup;</p> <p>Përgatitja e specifikave për çështje të TI;</p>	Përcjellje e vazhdueshme	SPZAP-it/ZKF/ZKA	
12	Menaxhimi i Pasurisë	12.1	<p>Regjistrimin e pasurisë si për inventar ashtu edhe për material administrative në SMFK dhe në sistemin e E-pasurisë;</p> <p>Menaxhimin e depos;</p> <p>Furnizimin e zyrtarëve të PZAP-it me inventar dhe material administrativ sipas kërkesave të zyrtarëve;</p> <p>Pranimin e mallit në SMFK;</p> <p>Mbikëqyrja, planifikimi dhe koordinimi për çështjet e logjistikes;</p> <p>Koordinimin e aktiviteteve në lidhje me akomodimin Brenda ndërtesës;</p> <p>Përgatitja e specifikave për çështje të logjistikes;</p>	Përcjellje e vazhdueshme	SPZAP-it/ZKF/ZKA	
13	Menaxhimi i transportit	13.1	<p>Menaxhimi i automjeteve zyrtare;</p> <p>Mirëmbajtja e përditshme e automjeteve zyrtare;</p> <p>Mbajtja e evidencave për qarkullimin e veturave zyrtare si dhe evidentimi i kilometrave të kaluara;</p> <p>Regjistrimin dhe sigurimin me kohë të automjeteve zyrtare;</p> <p>Përcjellja dhe kontrollimi i faturave dhe kuponëve për furnizim me derivate;</p> <p>Raportim për kilometrat e kaluara të automjeteve zyrtare;</p>	Përcjellje e vazhdueshme	SPZAP-it/ZKF/ZKA	

			Shërbime me veturave sipas kërkesave të zyrtarëve; Dërgimi i dokumenteve nga PZAP-i në vende të ndryshme Brenda Prishtinës dhe në regjione tjera;			
14	Organizimin dhe koordinimin e përkthimeve të materialeve dhe dokumenteve në PZAP	14.1	Organizimin dhe koordinimin sa më profesional të përkthimeve të materialeve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas; Përkthim të aty për atyshëm gjatë takimeve dhe seancave të PZAP-it nga shqipja në serbisht dhe anasjelltas si dhe përkthime me gojë në takime me PZAP-in kur është e nevojshme; Kontrollimin dhe lektorimin e të gjitha dokumenteve të përkthyer; Protokollimin e materialeve të përkthyer në librat e regjistrit; Pranimin e kërkesave për përkthim, klasifikimin dhe përgatitjen e materialeve përcjellëse.	Përcjellje e vazhdueshme	SPZAP-it/ZKF/ZKA	
15	Hartimi i Planit të Prokurimit për vitin 2015	15.1	Përgatitja e Planit preliminar dhe Final të Prokurimit për vitin 2015	Janar 2015	ZKA/ZKF/ Zyrtari i Prokurimit	
16	Inkasimi i Gjobjave të papaguara nga subjektet politike	16.1	Zbatimi i dispozitave ligjore për përmbarimin e obligimeve të papaguara nga ana e subjekteve politike. Përmes Zyrës së Përmbaruesit Privat, PZAP-i do të ndërmer veprimet e duhura procedurale ligjore për të përmbuar shumën gjobjave të papaguara nga ana e subjekteve politike në lartësi prej 30,350.00 €	Janar – dhjetor 2015	ZKA/ZKF, UZL	2,000.00 €
17	Përgatitja e një Strategjie Zhvillimore të PZAP-i duke përfshirë komunikimin me publikun	17.1	PZAP-i në bashkëpunim me IFES-in në vitin 2015 do të fillojnë të përgatisin një strategji zhvillimore për institucionin e PZAP-it e në këtë strategji të përfshihet komunikimi me publikun.	Shtator 2015 – dhjetor 2015	PZAP-IFES	